



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 8491 / Prot.

Tiranë, më 30.12: 2022

URDHËR

Nr. 758, datë 30.12. 2022

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR
PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të urdhrit nr. 100, datë 25.02. 2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:


1. Miratimin e programit të praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI





REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



ASCAP

PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

MIRATOHET

MINISTËR

EVIS KUSHI



**PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE
PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR
TË MËSUESIT**

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	2
HYRJE	3
Programi i praktikës profesionale për profesionin e mësuesit.....	3
Qëllimi i programit të praktikës profesionale	4
Elementet kryesore të programit të praktikës profesionale.....	5
Dimensioni personal	5
Dimensioni social.....	5
Dimensioni profesional.....	6
KOMPETENCAT.....	8
VLERËSIMI	13
Portofoli i praktikantit.....	13
Vlerësimi i praktikantit	13
Literatura.....	13
ANEKS. VLERËSIMI I PRAKTIKANTIT	15
UDHËZIME.....	20
VLERËSIMI I PRAKTIKANTIT.....	24
Vlerësimi për një tregues	24
Vlerësimi për një kompetencë	24
Vlerësimi i përgjithshëm.....	24

HYRJE

Programi i praktikës profesionale për profesionin e mësuesit

Programi i praktikës profesionale është hartuar për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin profesional të praktikantëve, kandidatë për mësues të rinj. Ai synon sigurimin e cilësisë së mësimdhënies nga mësuesit e rinj dhe performancë të lartë të profesionit të mësuesit; përvetësimin e mëtejshëm të njohurive teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe të normave të etikës e të sjelljes së mësuesit; zhvillimin e kapaciteteve të mësuesit të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies si dhe komunikimit me nxënësit. Programi realizohet gjatë praktikës profesionale që kryhet nga praktikanti, në mënyrë që kandidatët për mësues të zhvillojnë aftësitë, shprehitë dhe njohuritë e duhura që u nevojiten për të pasur sukses në profesionin e tyre si mësues.

Për hartimin e programit janë mbajtur parasysh këto dokumente themelore:

- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Urdhri i ministrit të Arsimit dhe të Sportit, nr.100, datë 25.02.2022 “ Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”
- Rregullorja “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, datë 25.02.2022.
- Shtojcat e rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, datë 25.02.2022
- Urdhri nr. 437, datë 20.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”
- Urdhri nr.46, datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

Të gjitha dokumentet e mësipërme, së bashku me programin e praktikës profesionale, mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit (MAS) arsimi.gov.al dhe të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) www.ascap.edu.al.

Programi i praktikës profesionale është ndërtuar si një material orientues dhe burimor, i bazuar gjerësisht në Rregulloren e miratuar të kësaj praktike. Përdoruesit e tij: praktikantët, mentorët, drejtuesit e shkollave, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) duhet t'i referohen Rregullores për shpjegime të mëtejshme të procesit, rolit dhe përgjegjësisë, si edhe modelit të instrumenteve përkatëse për procesin. Programi ka një fokus të veçantë në aspektin përmbajtësor të praktikës.

Programi është i organizuar në tri pjesë kryesore.

Pjesa e parë paraqet një hyrje dhe një pamje të përgjithshme të programit, qëllimit të tij dhe dokumenteve ku bazohet.

Pjesa e dytë është një përcaktim i detajuar i kompetencave që duhet të fitojë praktikanti në përfundim të praktikës profesionale.

Pjesa e tretë ofron një përmbledhje të procedurës së vlerësimit dhe të monitorimit të praktikantit.

Qëllimi i programit të praktikës profesionale

Programi i praktikës profesionale synon të ofrojë për mësuesit e ardhshëm një sistem mbështetjeje që përfshin të nxënit në mjedisin e punës, duke punuar me një mentor të kualifikuar, për të rritur efektivitetin e mësimdhënies dhe rezultatet e të nxënit. Ai synon të nxitë motivimin e mësuesve të ardhshëm për profesionin e mësuesit, të nxitë bashkëpunimin e tyre me komunitetin e shkollës dhe të ndihmojë në zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale.

Programi i praktikës profesionale ka dy qëllime kryesore:

- Të ndihmojë praktikantët të realizojnë përgatitjen për periudhën e praktikës profesionale, t'i udhëzojë ata në vetëvlerësimin e tyre, duke ngritur nivelin e zhvillimit të tyre profesional.
- Të ndihmojë drejtuesit e shkollave dhe mentorët që të udhëheqin dhe të lehtësojnë procesin e zhvillimit profesional të praktikantëve përgjatë praktikës së tyre profesionale dhe të vlerësojnë performancën e tyre.

Elementet kryesore të programit të praktikës profesionale

Mësuesit e rinj kanë nevojë për një mbështetje në tri dimensione: personal, social dhe profesional. Programi i paraqitur merr parasysh të tria këto dimensione, të cilat janë përshkruar referuar edhe dokumenteve evropiane për hartimin e programeve të praktikave profesionale për praktikantët, kandidatë për mësues të rinj.

Dimensioni personal

Mbështetja personale ndihmon mësuesin e ri të zhvillojë identitetin e tij si mësues. Në muajt dhe vitet e para të profesionit, atij i duhet të kapërcejë sfida profesionale dhe personale të ndryshme. Ky dimension përfshin zhvillimin dhe përpunimin e normave personale për marrëdhëniet me nxënësit dhe me kolegët, përpunimin e këndvështrimeve për të nxënit, mësimdhënien dhe rolin e saj në këto procese, si dhe zhvillimin e një qëndrimi të të nxënit afatgjatë etj. Në këtë dimension, emocionet dhe perceptimet e vetë-efikasitetit dhe vetëvlerësimit të mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm.

Për të krijuar këtë mbështetje, është e rëndësishme të përmbushen disa elemente, si: mbështetja nga mentori dhe kolegët, mjedisi i sigurt i punës dhe ngarkesa e reduktuar e punës.

Dimensioni social

Programi i praktikës profesionale ndihmon mësuesin e ri për t'u ndjerë pjesë organike e shkollës dhe komunitetit profesional, për të kuptuar dhe pranuar cilësitë, normat, mënyrat dhe strukturën organizative brenda shkollës. Bashkëpunimi me të tjerët nxit shkëmbimin e ideve. Një faktor i rëndësishëm në mbështetjen sociale është kultura e shkollës. Mësuesit e

rinj ndihen më të pranuar brenda një ekipi që është i hapur ndaj ideve të reja. Mbështetja sociale mundëson krijimin dhe mbështetjen e një mjedisi të nxëni bashkëpunues brenda shkollës dhe aktorëve të arsimit. Elemente të mbështetjes sociale mund të jenë mbështetja nga mentori dhe bashkëpunimi i ngushtë me mësues të tjerë.

Dimensionimi profesional

Praktika profesionale synon të zhvillojë shprehitë efektive të mësimdhënies në klasë dhe të thellojë njohuritë e lëndës, pedagogjisë dhe didaktikës. Me mbështetjen profesionale sigurohet një fillim i mbarë në procesin e të nxënit afatgjatë. Elemente të kësaj mbështetjeje janë kontributet nga ekspertët e universiteteve apo institucioneve të trajnimit të mësuesve në formën e seanceve trajnuese dhe shkëmbimit të njohurive praktike midis praktikantëve, kandidatë për mësues të rinj dhe atyre me përvojë në shkolla të ndryshme apo në kuadër të rrjeteve profesionale.

Tabela 1. Llojet e mbështetjes për praktikantët, kandidatë për mësues të rinj

	Personal	Social	Profesional
Synimet e programit	<ul style="list-style-type: none"> - Të zhvillojë identitetin si mësues. - Të përforcojë kompetencat kyç të mësuesit. - Të rrisë vetëbesimin. - Të reduktojë stresin. - Të motivojë mësuesit e rinj dhe të shmangë 	<ul style="list-style-type: none"> - Të rrisë shoqërizimin në shkollë dhe profesion. - Të nxisë bashkëpunimin mes kolegëve. - Të nxisë krijimin e një mjedisi të nxëni bashkëpunues. - Të nxisë përfshirjen e 	<ul style="list-style-type: none"> - Të zhvillojë më tej kompetencat e mësuesve. - Të lidhë edukimin fillestar të mësuesit me zhvillimin e vazhdueshëm profesional. - Të rrisë profesionalizmin e mësuesve të rinj.

	tërheqjen e tyre nga detyra.	komunitetit të shkollës.
Kërkesat kyç	<ul style="list-style-type: none"> - Mjedis i sigurt, jo paragjykues. - Ngarkesë pune e reduktuar. - Mësimdhënie në ekip dhe bashkëpunim. 	<ul style="list-style-type: none"> - Puna në bashkëpunim - Bashkëpunimi në mësimdhënie. - Punë grupi. - Pjesëmarrja në projekte. - Pjesëmarrje në rrjete profesionale. <ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbime eksperiencash mes mësuesve me përvojë dhe mësuesve të rinj. - Kualifikime dhe trajnime të vazhdueshme në nivel shkolle e lokal dhe kur është e mundur në nivel kombëtar. - Këshillime.
Sistemet e duhura të mbështetjes	<ul style="list-style-type: none"> - Mentorët - Kolegët - Vetëmotivim - Vetëvlerësim 	<ul style="list-style-type: none"> - Mentorët - Kolegët - Motivim nga kolegët dhe nga stafi drejtues. - Vlerësim nga kolegët dhe nga stafi drejtues. <ul style="list-style-type: none"> - Mentorët - Kolegët - Ekspertët e jashtëm - Vlerësuesit e jashtëm - Motivim nga kolegët dhe nga stafi drejtues. - Vlerësim nga kolegët dhe stafi drejtues.

© Komisioni Evropian

KOMPETENCAT

Kompetencat përfshijnë aftësi, dije dhe qëndrime që kërkohen të arrihen nga praktikantët, kandidatë për mësues të rinj, në përfundim të praktikës së tyre profesionale. Këto kompetenca janë përcaktuar në Shtojcën 3 të Rregullores (si dhe në aneksin e këtij programi), ku praktikanti:

- ❖ duhet të njohë legjislacionin që ka të bëjë drejtpërdrejt me veprimtarinë e mësuesit;
- ❖ duhet të njohë dokumentacionin kurrikular për profilin përkatës;
- ❖ duhet të zotërojë dhe të jetë i përgatitur për anën shkencore të lëndës;
- ❖ duhet të zhvillojë mësimdhënie sipas praktikave të suksesshme bashkëkohore të mësimdhënies, të nxënimit dhe të vlerësimit të nxënësve;
- ❖ duhet të përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi;
- ❖ duhet të vlerësojë sistematikisht nxënësit me larmi teknikash vlerësimi;
- ❖ duhet të respektojë normat e etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor;
- ❖ duhet të jetë aktiv dhe produktiv në bashkëpunimin me kolegët

Çdo kompetencë është e zbrërthyer në disa rezultate të pritshme sipas treguesve.

Kompetenca	Rezultatet e pritshme sipas treguesve
Njeh dokumentacionin zyrtar dhe e plotëson në përputhje me rregullat zyrtare	Praktikanti: <ul style="list-style-type: none">- njeh dhe zbaton Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë;- zbaton udhëzimin e MAS-it për vitin shkollor kur praktikanti bën praktikën profesionale;- njeh dhe merr pjesë në organizimin dhe funksionimin e strukturave organizative të shkollës;- zbaton udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;

	<ul style="list-style-type: none"> - zbaton udhëzimet për zbatimin e reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar; - zbaton në praktikën e përditshme kërkesat që burojnë nga dokumentacioni zyrtar; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie - mësimnxënies; - zbaton udhëzimet për personelin e shkollës; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zotëron kriteret dhe parimet e plotësimit të dokumentacionit shkollor, si regjistri, dëftesa, amza etj.
<p>Është i përgatitur nga ana shkencore</p>	<p>Praktikanti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon strukturën e programeve të lëndës që jep mësim për të gjitha klasat, brenda ciklit; - zotëron njohuritë lëndore me saktësi shkencore; - planifikon orët mësimore dhe veprimtaritë e mësimdhënies, duke u mbështetur në programin mësimor dhe në nivelet e arritjeve; - planifikon dhe realizon rezultatet e të nxënësit në mbështetje të arritjeve të nxënësve si dhe i konkretizon ato në situata të nxëni nga jeta reale; - planifikon dhe përdor burime të shumëllojshme të nxëni, duke bashkëpunuar me kolegët, prindërit e komunitetin; - zotëron aftësitë digjitale dhe përdor TIK- un në procesin e mësimdhënie – nxënies;

	<ul style="list-style-type: none"> - përditëson informacionin e tekstit, duke përdorur burime të ndryshme informacioni; - njeh standardin e gjuhës shqipe dhe zbaton normat e tij në veprimtaritë institucionale; - përdor dhe zbaton me efikasitet njohuritë bazë të leximit - shkrimit digjital.
<p>Zhvillon mësimdhënie sipas praktikave të suksesshme bashkëkohore</p>	<p>Praktikanti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënës; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve, të menduarin kritik, barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - evidenton dhe përdor mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e arritjeve të nxënës; - planifikon dhe zhvillon projekte interesante kurrikulare duke përfshirë edhe TIK-un; - përdor stile të ndryshme të nxënës.
<p>Vlerëson sistematikisht nxënësit me një larmi mënyrash vlerësimi</p>	<p>Praktikanti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënës; - përdor vlerësimin si pjesë e procesit të të nxënës për të nxitur përmirësimin e arritjeve të nxënës; - ndërton pyetje ose veprimtari mësimore që mundësojnë vlerësimin real të nxënës duke u bazuar në nivelet e arritjes;

	<ul style="list-style-type: none"> - drejton pyetje që parandalojnë të nxënit mekanik e riprodhues duke nxitur aftësi të mendimit kritik dhe krijues; - shpjegon dhe zbaton parimet e hartimit të një testi, duke ndërtuar pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme që vlerësojnë rezultatet e të nxënit; - harton teste për matjen dhe diagnostikimin në vazhdimësi të arritjeve të nxënësve.
<p>Përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi</p>	<p>Praktikanti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor njohuritë mbi zhvillimin fizik, social dhe intelektual të nxënësve në arsimin parauniversitar, në veprimtaritë e procesit të mësimdhënie - nxënies; - balancon ngarkesën e nxënësit në klasë dhe në shtëpi duke u kujdesur për të mos e mbingarkuar atë me më shumë njohuri se sa i kërkohet; - përgjigjet në mënyrën e duhur ndaj nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në të nxënë; - përshtat mësimdhënien në forma të ndryshme në përputhje dhe në dobi të stilit individual të të nxënit të nxënësit; - zhvillon dhe mbështet marrëdhënie të hapura me nxënësit, të bazuara mbi respektin dhe besimin e ndërsjellë; - motivon nxënësin për të përmirësuar të nxënit e tij.
<p>Respekton normat e etikës dhe të sjelljes në institucionin arsimor</p>	<p>Praktikanti:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - demonstroi një qëndrim pozitiv dhe profesional gjatë komunikimit me prindërit, nxënësit dhe kolegët, duke zbatuar Kodin e Etikës së Mësuesit; - shmang çdo lloj dhune psikologjike dhe fizike ndaj nxënësve apo kolegëve; - komunikon tek nxënësit pritshmëri të qarta, të arritshme dhe motivuese.
<p>Është aktiv dhe produktiv në bashkëpunimin me kolegët</p>	<p>Praktikanti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton rregullat e të punuarit në grup dhe në ekip; - përdor mënyra të larmishme për të shkëmbyer informacion me kolegët; - mbështet veprimtari dhe programe, të cilat inkurajojnë prindërit të marrin pjesë aktivisht në veprimtari të organizuara në shkollë; - merr pjesë në veprimtari të zhvillimit profesional në nivel shkollor lokal dhe kur është e mundur edhe në nivel kombëtar.

VLERËSIMI

Portofoli i praktikantit

Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikanti duhet të plotësojë portofolin e tij me përvojat më të mira të fituara dhe të zbatuara. Portofoli përmban:

- planin lëndor vjetor,
- planin e periudhës për lëndën përkatëse,
- 2 – 3 modele të planeve ditore të orëve mësimore,
- 2 -3 teste të kapitujve ose të periudhës,
- 1-2 modele të projekteve kurrikulare të zhvilluara me nxënësit,
- 3 – 4 shembuj të metodave që ka përdorur praktikanti për të formuar te nxënësit aftësitë e komunikimit me gojë dhe me shkrim, të menduarit kritik, të menduarit krijues, të punuarit në grup, të gjithëpërfshirjes, të menaxhimit të informacionit mësimor nga burime të ndryshme; për të përdorur TIK-un në mësimdhënie; për të punuar me nxënësit me vështirësi në të nxënë; për të punuar me nxënësit me prirje të veçanta.

Portofoli duhet të përmbajë gjithashtu “Raportin e praktikantit” me reflektime mbi përvojat e tij gjatë praktikës profesionale, me sukseset më të spikatura dhe vështirësitë kryesore.

Vlerësimi i praktikantit

Ky program i mundëson praktikantit që të vetëvlerësohet duke u ballafaquar me treguesit e kompetencave si dhe me rezultatet e pritshme të praktikës profesionale. Programi është i vlefshëm gjithashtu për mentorin dhe drejtuesin e institucionit arsimor, të cilët do të vlerësojnë praktikantin kundrejt arritjes së treguesve të çdo kompetence sipas shtojcave të Rregullores, të vendosura edhe në aneksin e këtij programi.

Literatura

Praktikanti do të mbështetet dhe do të përdorë burime të literaturës bashkëkohore për të plotësuar dhe për të përforcuar njohuritë dhe aftësitë e tij. Ai mund të këshillohet me

mentorin, stafin e shkollës, institucionet e arsimit, si dhe me agjenci trajnuese të akredituara për sigurimin dhe shfrytëzimin e burimeve të saj.

Është e rëndësishme që gjatë periudhës së praktikës, praktikanti të konsultojë dhe shfrytëzojë materiale të botuara që i përgjigjen kompetencave të sipërpërmendura siç mund të jenë:

- ✓ Dokumente zyrtare të MAS-it në lidhje me legjislacionin dhe dokumentacionin shkollor.
- ✓ Dokumentacion kurrikular që lidhet me lëndën që zhvillon, i publikuar në faqen zyrtare të ASCAP-it.
- ✓ Udhëzues dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve, të publikuar në faqen zyrtare të ASCAP-it.
- ✓ Botime në fushën e mësimdhënies dhe të nxënësve.
- ✓ Botime në fushën e vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
- ✓ Botime në fushën e psikologjisë së zhvillimit dhe të edukimit.
- ✓ Botime që trajtojnë aspekte të komunikimit dhe të etikës në shkollë.
- ✓ Botime në lidhje me zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare.
- ✓ Materiale evropiane dhe botërore që lidhen me zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

ANEKS. VLERËSIMI I PRAKTIKANTIT

DRAP/ZVAP _____

Shkolla: _____

Niveli arsimor: _____

Lënda: _____

Kompetenca 1: NJEH DOKUMENTACIONIN ZYRTAR DHE E PLOTËSON NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT ZYRTARE

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Njih legjislacionin arsimor parauniversitar dhe e zbaton atë.	
2	Njih Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, si dhe e zbaton atë.	
3	Njih rregulloren e brendshme institucionit arsimor dhe e zbaton atë.	
4	Njih dokumentet kurrikulare dhe i zbaton ato.	
5	Njih programin lëndor dhe e zbaton në planifikimin e lëndës.	
6	Harton, sipas formatit zyrtar, planin mësimor vjetor dhe të periudhës për lëndën përkatëse, në përshtatje me tekstin e përzgjedhur.	
7	Harton rregullisht planin e tij ditor.	
8	Plotëson saktë dokumentacionin shkollor.	
	Pikët e kompetencës	
	VLERËSIMI	

Kompetenca 2: ËSHTË I PËRGATITUR NGA ANA SHKENCORE

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Zotëron anën shkencore të lëndës.	
2	Sjell rregullisht konkretizime të njohurive lëndore në situata të nxëni nga jeta reale.	
3	Përditëson informacionin e tekstit shkollor.	
4	Zotëron komunikimin në gjuhën standarde.	
5	Zotëron njohuritë e përdorimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies.	

6	Zotëron njohuritë e përdorimit të matematikës në mësimdhënie ¹ .	
7	Zotëron njohuritë e lëndëve të tjera që e ndihmojnë në mësimdhënien e lëndës së tij.	
8	Shfrytëzon burime të tjera informacioni përveç tekstit shkollor.	
Pikët e kompetencës		
VLERËSIMI		

Kompetenca 3: ZHVILLON MËSIMDHËNIE SIPAS PRAKTIKAVE TË SUKSESSHME BASHKËKOHORE

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Sigurohet që nxënësit kanë njohuritë e mjaftueshme paraprake dhe i lidhin ato me temën e mësimin.	
2	U drejton nxënësve pyetje që synojnë përvetësimin e thellë të koncepteve kryesore e të lidhjeve mes tyre dhe që parandalon të nxënit mekanik dhe riprodhues, duke nxitur aftësi të mendimit kritik e krijues.	
3	Organizon periodikisht përsëritje efektive të njohurive.	
4	Gjatë vitit shkollor bën ndryshime në planifikimin lëndor në përshtatje me rrethanat e reja që i krijohen.	
5	Kultivon te nxënësit aftësinë e punës së pavarur individuale.	
6	Kultivon te nxënësit aftësinë e tyre për punën me grupe të vogla brenda në klasë dhe jashtë saj.	
7	Zhvillon projekte interesante kurrikulare.	
8	Nxit debatet mes nxënësve për përmbushjen nga ata të kompetencave dhe të rezultateve të të nxënit të programit lëndor.	
9	Synon të aftësojë te nxënësit kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.	
10	Mban qëndrim pozitiv ndaj gabimeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënit dhe favorizon diskutimet mes tyre për të gjetur përgjigjen e duhur.	
11	Studion literaturë pedagogjike që lidhet me zhvillimin e tij profesional.	
Pikët e kompetencës		
VLERËSIMI		

¹ Ky tregues nuk përdoret për mësuesin e matematikës.

Kompetenca 4: PËRKUJDESET PËR SUKSESIN E ÇDO NXËNËSI

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Nuk i mbingarkon nxënësit me njohuri jashtë programit lëndor.	
2	Është krijuar në përdorimin e tekstit shkollor duke pasur në qendër të vëmendjes se sa nxënësit mund ta përvetësojnë atë	
3	Në klasë të gjithë nxënësit janë të vëmendshëm dhe aktivë.	
4	Përkujdeset posaçërisht në klasë dhe jashtë saj, për nxënësit me vështirësi në të nxënë.	
5	Ka rezultate të larta në arritjet e nxënësve.	
6	U ofron kërkesa sfiduese në klasë dhe jashtë saj, nxënësve që shfaqin interes të veçantë për lëndën.	
7	Detyrat e shtëpisë ua jep nxënësve sipas nevojave të tyre.	
8	Bashkëpunon me prindërit e nxënësve për të përmirësuar arritjet e tyre.	
	Pikët e kompetencës	
	VLERËSIMI	

Kompetenca 5: VLERËSON SISTEMATIKISHT NXËNËSIT ME NJË LARMI MËNYRASH VLERËSIMI

NR	TREGUESIT	Pikët
1	I sqaron paraprakisht nxënësit për kriteret dhe mënyrën se si do të vlerësohen (me gojë, me shkrim dhe në veprimtari të tjera praktike).	
2	Gjatë vlerësimeve të nxënësve me gojë ose me shkrim formulon kërkesa që i nxisin nxënësit të thellohen në konceptet dhe në lidhjet mes tyre.	
3	Zhvillon dhe analizon me nxënësit teste ose detyrat e ndërmjetme apo të periudhës.	
4	Vlerëson projektin e nxënësit/ve duke i inkurajuar ata të zhvillojnë detyra sa më krijuese.	
5	Vlerëson çdo nxënës duke përdorur nivelet e arritjes.	
6	Ushtron nxënësit të vetëvlerësohen ose të realizojnë vlerësimin e njëri – tjetrit.	
	Pikët e kompetencës	
	VLERËSIMI	

Kompetenca 6: RESPEKTON NORMAT E ETIKËS DHE TË SJELLJES NË INSTITUCIONIN ARSIMOR

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Zbaton rregullat e institucionit arsimor dhe Kodin e Etikës së Mësuesit.	
2	Nuk ushtron dhunë psikologjike ndaj nxënësve.	
3	Nuk ushtron dhunë fizike ndaj nxënësve.	
4	Nuk kryen veprime që u shkaktojnë nxënësve dëmtim moral.	
5	Ka etikë me nxënësit, kolegët dhe eprorët.	
	Pikët e kompetencës	
VLERËSIMI		

Kompetenca 7: ËSHTË AKTIV DHE PRODUKTIV NË BASHKËPUNIMIN ME KOLEGËT

NR	TREGUESIT	Pikët
1	Është i gatshëm të mësojë nga përvoja e kolegëve.	
2	Merr pjesë në aktivitetet që organizon institucioni arsimor.	
3	Merr pjesë aktive në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimtarive të institucionit.	
4	Merr pjesë në mbledhjet e këshillit të mësuesve, shfaq interes për diskutimet profesionale në to dhe parashtron ide.	
5	Merr pjesë në mbledhjet e ekipit lëndor dhe shfaq interes për diskutimet profesionale në to dhe parashtron ide.	
	Pikët e kompetencës	
VLERËSIMI		

Praktikanti _____ ka kryer praktikën profesionale gjatë periudhës _____ në _____ dhe është vlerësuar si më poshtë:

NR	KOMPETENCAT	VLERËSIMI
1	Njeh dokumentacionin zyrtar dhe e plotëson në përputhje me rregullat zyrtare.	
2	Është i përgatitur nga ana shkencore	
3	Zhvillon mësimdhënie sipas praktikave të suksesshme bashkëkohore	
4	Përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi.	
5	Vlerëson nxënësit me një larmi mënyrash vlerësimi	
6	Respekton normat e etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor	
7	Është aktiv dhe produktiv në bashkëpunimin me kolegët	
	Pikët për vlerësimin e praktikantit	
VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM		

Mentori _____ Drejtori i shkollës _____

Data ____ / ____ / ____

UDHËZIME

Për disa nga treguesit që e ndihmojnë mentorin dhe drejtorin e shkollës të vlerësojë në mënyrë më objektive, ka komente si më poshtë:

Kompetenca 1: NJEH DOKUMENTACIONIN ZYRTAR DHE E PLOTËSON NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT ZYRTARE

NR	TREGUESIT
5	Njih programin lëndor dhe e zbaton në planifikimin e lëndës. Njih kompetencat lëndore, rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore duke përcaktuar qartë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
6	Harton, sipas formatit zyrtar, planin mësimor vjetor dhe të periudhës për lëndën përkatëse në përshtatje me tekstin e përzgjedhur. Zbaton udhëzimet përkatëse për hartimin e planeve mësimore.
7	Harton rregullisht planin e tij ditor. Plani ditor përmban të gjitha rubrikat e përcaktuara në udhëzimet përkatëse të dokumenteve kurrikulare.
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

Kompetenca 2: ËSHTË I PËRGATITUR NGA ANA SHKENCORE

NR	TREGUESIT
1	Zotëron anën shkencore të lëndës. Nuk bën gabime shkencore. Jep përgjigje të sakta për kërkesat e tekstit shkollor (pyetje, ushtrime, problema). Korrigjon saktë gabimet shkencore të nxënësve.
2	Sjell rregullisht konkretizime të njohurive lëndore në situata të nxëni nga jeta reale. Konkretizon njohuritë lëndore me shembuj nga jeta e përditshme dhe nga ngjarje aktuale.
3	Përditëson informacionin e tekstit shkollor.

	U sjell nxënësve informacione për të rejat teknologjike dhe shkencore, për ngjarjet social-politike në vend ose në botë, për fushën e arteve, për shëndetin etj., me anën e të cilave përmbush më mirë rezultatet e të nxënësve të programit lëndor.
4	Zotëron komunikimin në gjuhën standarde.
	Drejtsqipton e drejtshkruan gjuhën amtare dhe atë zyrtare. Ka fjalor të pasur. Nuk përdor fjalë të huaja të panevojshme. I strukturon mirë fjalitë dhe informacionin lëndor.
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

Kompetenca 3: ZHVILLON MËSIMDHËNIE E NXËNIE SIPAS PRAKTIKAVE TË SUKSESSHME BASHKËKOHORE

NR	TREGUESIT
3	Organizon periodikisht përsëritje efektive të njohurive.
	Organizon nxënësit, në klasë dhe jashtë saj, në mënyrë individuale dhe në grupe të vogla, të përmbledhin çfarë kanë nxënë gjatë disa orëve mësimore, të lidhin njohuritë e mësuara rishtas me ato të kapitujve paraardhës, me ato të vitit të kaluar dhe me njohuri të lëndëve të tjera.
4	Gjatë vitit shkollor bën ndryshime në planifikimin lëndor në përshtatje me rrethanat e reja që i krijohen.
	Mund të ndryshojë numrin e orëve për një kapitull, duke shtuar ose duke pakësuar deri në 10% të orëve të kapitullit, për shkak të përvetësimit të pamjaftueshëm ose përvetësimit të shpejtë të njohurive sipas rezultateve të programit lëndor.
	Mund të ndryshojë temat e projekteve kurrikulare ose mund të rishpërndajë orët për një temë mësimore që ka nevojë për t'u trajtuar ende nga nxënësit.
7	Zhvillon projekte interesante kurrikulare.
	E planifikon projektin kurrikular sipas formatit. Nxist nxënësit të ideojnë tema të projekteve kurrikulare. Bashkëpunon me mësues të tjerë në projekte kurrikulare. Ndhmon nxënësit të hartojnë planin e tyre të projektit kurrikular, të formojnë grupe pune dhe të shpërndajnë qartë dhe mirë detyrat individuale në këto grupe, si dhe të përgatisin prezantimin e projektit dhe raportin e tij.
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

Kompetenca 5: VLERËSON NXËNËSIT ME NJË LARMI MËNYRASH

VLERËSIMI

NR	TREGUESIT
2	<p>Gjatë vlerësimeve të nxënësve me gojë ose me shkrim formulon kërkesa që i nxisin nxënësit të thellohen në konceptet dhe në lidhjet mes tyre.</p> <p>Kërkesat nuk kufizohen vetëm në njohuritë e kapitullit ose të kapitujve aktualë, por lidhin këto njohuri me ato të kapitujve paraardhës, të lëndëve të tjera dhe të viteve paraardhëse.</p> <p>Si rregull, kërkesat nuk janë fotokopje e kërkesave të librit, por parashtrojnë situata të patakuara në tekst, por që shfrytëzojnë njohuritë e tekstit. Kërkesat/pyetjet janë të llojeve dhe niveleve të ndryshme.</p>
4	<p>Vlerëson projektin e nxënësve duke inkurajuar ata të zhvillojnë detyra sa më krijuese.</p> <p>Projekti kurrikular është një krijim origjinal i nxënësve që bazohet në zbatimin praktik dhe në demonstrimin e aftësive që ata kanë fituar jo vetëm në lëndën përkatëse, por edhe në lëndë të tjera.</p>
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

Kompetenca 6: RESPEKTON NORMAT E ETIKËS DHE TË SJELLJES NË INSTITUCIONIN ARSIMOR

NR	TREGUESIT
1	<p>Zbaton rregullat e institucionit arsimor dhe Kodin e Etikës së Mësuesit.</p> <p>Është i përpiktë në respektimin e orarit mësimor dhe të veprimtarive të tjera të institucionit. I kryen brenda afatit detyrat zyrtare. Është korrekt në zbatimin e Kodit të Etikës së Mësuesit.</p>
2	<p>Nuk ushtron dhunë psikologjike ndaj nxënësve.</p> <p>Nuk fyen, nuk ironizon, nuk paragjykon.</p>
4	<p>Nuk kryen veprime që u shkaktojnë nxënësve dëmtim moral.</p> <p>Nuk përfiton materialisht dhe financiarisht nga nxënësit. Nuk zhvillon me ta biseda të pahijshme.</p>
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

Kompetenca 7: ËSHTË AKTIV DHE PRODUKTIV NË BASHKËPUNIMIN ME

KOLEGËT

NR	TREGUESIT
1	Është gatshëm të mësojë nga përvoja e kolegëve. Kërkon mendime nga kolegët për probleme të ndryshme të mësimdhënies dhe për metodat që përdor me nxënësit.
	Pikët e kompetencës
	VLERËSIMI

VLERËSIMI I PRAKTIKANTIT

Vlerësimi për një tregues

Për çdo tregues të kompetencave, shënohet te kolona “Pikët” njëri nga numrat 1, 2, 3, 4.

Numri 4 vendoset, kur për atë tregues praktikanti vlerësohet me “Shumë mirë”. Numri 3 vendoset për vlerësimin “Mirë”, numri 2 për vlerësimin “Mjaftueshëm” dhe numri 1 për vlerësimin “Dobët”.

Treguesit për kompetencat 1-5 plotësohen nga mentori, kurse për kompetencat 6 e 7 plotësohen nga drejtori i shkollës në bashkëpunim me mentorin.

Vlerësimi për një kompetencë

Mblidhen pikët e të gjithë treguesve të kompetencës. Kjo shumë pjesëtohet me numrin e treguesve dhe rezultati rumbullakoset:

- ✓ “Sh. mirë”, kur rezultati është nga 3,4 deri në 4.
- ✓ “Mirë”, kur rezultati është nga 2,6 deri në 3,3.
- ✓ “Mjaftueshëm”, kur rezultati është nga 1,8 deri në 2,5.
- ✓ “Dobët”, kur rezultati është nga 1 deri në 1,7.

Vlerësimi i përgjithshëm

Mblidhen pikët me një shifër pas presjes dhjetore për të gjitha kompetencat. Kjo shumë pjesëtohet me numrin e kompetencave (7) dhe rezultati i rumbullakosur me një shifër pas presjes vendoset te rreshti “Pikët për vlerësimin e praktikantit” i tabelës për vlerësimin e përgjithshëm. Vlerësimi është “Shumë mirë” ose “Mirë” ose “Mjaftueshëm” ose “Dobët”, sipas të njëjtit rregull si te vlerësimi i secilës kompetencë.

Drejtori i shkollës dhe mentori firmosin në fund të vlerësimit, duke ia bërë të njohur vlerësimin edhe praktikantit.

PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT

Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

www.ascap.edu.al
sekretaria@ascap.edu.al

(+355) 4256440 / 4256441

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**